



NUMRI I PËRGJITHSHËM
I PIKËVE TË FITUARA

QENDRA
E PROVIMEVE
GARAT
SHTETËRORE 2024

SHIFRA E
NXËNËSIT

SHKOLLA FILLORE, KLASA VI

MATEMATIKË



TESTIN E KONTROLLOI

PODGORICË,

20

Të dashura nxënëse dhe nxënës,

Urime! Keni arritur që të vini në garat shtetërore nga matematika dhe me këtë hap keni arrite një sukses të madh. Prandaj detyrat që janë para jush shikoni si një problem interesant dhe përpiquni që t'i zgjidhni me një kujdes dhe angazhim të plotë, por edhe me një kënaqësi.

Renditja e zhvillimit të detyrave nuk është e rëndësishme. Nëse ndonjë detyrë ju duket shumë e vështirë, mos u ndalni shumë në të, por kaloni në detyrën tjetër. Nëse ju mbetet kohë, kthehuni dhe provoni t'i zgjidhni përsëri ato detyra të cilat nuk i keni zgjidhur.

Shkruani lexueshëm, posaçërisht numrat! Të gjitha përgjigjet agrumentoni hollësisht!

Punoni në mënyrë të pavarur. Nuk lejohet asnjë lloj bashkëbisedimi.

Gjatë punës mund të përdorni lapsin kimik dhe veglat shkollore për vizatimin e figurave gjeometrike, por nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë, kalkulatorëve dhe mjeteve tjera ndihmëse elektronike.


Për çdo detyrë janë paraparë nga 25 pikë.

Për punë keni 180 minuta.



Mund të filloni nga puna.

Me fat!

1. Në Podgoricë hapet shitorja e re e teknikës. Që të tërheqin sa më shumë blerës pronarët e shitores kanë organizuar lojë shpërblyese. Në ditën e hapjes çdo blerësit të 10-të i dhurojnë kufjet, çdo të 12-tit altoparlantët dhe çdo të 25-tit blerës i dhurojnë telefonin. Një blerës mund të fitojë tri dhurata përnjëherë. Para shitores është rendi i blerësve që presin hapjen e shitores. Hana dhe Zamira duan të fitojnë nga tri dhurata. Në cilat dy pozicione në rend para shitores duhet të qëndrojnë ashtu që edhe njëra edhe tjetra të fitojnë të tri dhuratat dhe të kalojnë sa më pak kohë duke pritur?



2. Mjeshtri Zamiri ka vendosur të rinovojë kuzhinën dhe të zëvendësojë pllakat e vjetra. Kuzhina e tij është e gjatë 6m dhe e gjerë 3,6m, ndërsa lartësia e tavanit është 2,4m. Pllakat e vjetra janë të formës së katrorit me gjatësi të brinjës 15cm dhe mbulojnë dyshemenë dhe muret deri në tri të katërtat e lartësisë së tavanit, përveç derës që ka gjerësinë 120cm dhe lartësinë 2m. Dera nga qoshja më e afërt e dhomës është në largësi 60cm si në figurë. Ai ka planifikuar të blejë dy lloje të reja të pllakave, njërin për dysheme ndërsa tjetrën për mure dhe të mbulojë të njëjtën sipërfaqe që kanë mbuluar pllakat e vjetra. Për pllakat e dyshemesë ka zgjedhur dimensionin 20 cm×10 cm, ndërsa për pllakat e murit dimensionin 18 cm×12 cm. Çmimi i pllakave të dyshemesë është 17 euro për metër katror, ndërsa çmimi i pllakave të murit është 23 euro për metër katror. Sa pllaka të vjetra gjenden në kuzhinë? Sa pllaka të dyshemesë e sa pllaka të murit duhet të blejë Zamiri dhe sa të holla do të harxhojë?



3. Në shënimin shifror në vijim

$$\begin{array}{r} Z A D A C I \\ + Z U D A C I \\ + Z I D A C I \\ + Z T T A C I \\ \hline \end{array}$$

shkronjat Z, A, D, C, I, U dhe T paraqesin 7 shifra të ndryshme dhe vlen $Z \neq 0$. Përcakto vlerat e shkronjave ashtu që vlera e shumës në shënimin shifror të jetë sa më e vogël e mundshme dhe pastaj të llogaritet ajo shumë.

4. Bibliotekari ka hasë në një libër të çuditshëm faqet e të cilit janë të numëruara gabimisht. Faqet janë të numëruara ashtu që të gjithë numrat paraqiten nga dy herë: 1, 2, 1, 2, 3, 4, 3, 4, 5, 6, 5, 6, etj. Nëse dihet se në këtë numërim të pasaktë janë përdorur 816 shifra, përcaktoni cili numër do të jetë i shënuar në faqen e fundit të librit pasi që bibliotekari të përmirësojë gabimin dhe të numërojë saktë faqet e librit.

